



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

NR. 59, Datë 05.04.2019

**PËR SKUALIFIKIMIN E KANDIDATIT PËR PROKUROR PRANË PROKURORISË
SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Në bazë të nenit 179/8 të Kushtetutës, të nenit 166, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të nenit 7 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të nenit 47 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

- I. Të skualifikojë Z. Gëzim Cenaj, kandidat për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, i cili pas vlerësimit paraprak, rezulton se nuk plotëson kushtet ligjore për ngritjen në detyrë, parashikuar në nenin 47 pika 1, gërma b dhe pika 2, gërma c të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi nuk ka ushtruar asnjëherë funksionin si prokuror në Republikën e Shqipërisë.
- II. Të njoftohet me këtë vendim Z. Gëzim Cenaj.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI

ALFRED BALLA



RETA
-ESI

ANËTAR

ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR

GENTJAN OSMANI

ANËTAR

SANDËR BECI

ANËTAR

BESNIK CANI

ANËTAR

KOSTAQ BELURI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

NURIHAN SEFI

ANËTAR

TARTAR BAZAJ